



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:245649
Datë: 26.11.2024
Numri i dokumentit: 06511213

AA.nr.100/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, e me bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, B.Sh nga Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Labinot Vata, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Komuna e Prizrenit, me bazën juridike anulim i njoftimit, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2330/2021, të datës;27.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;31.10.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e palës së paditur, Komuna e Prizrenit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2330/2021, i datës;27.12.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, nën shenjën A.nr.2330/2021, të datës;27.12.2023, është vendosur, *“I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, B.Sh nga komuna e Prizrenit. II. Anulohet Njoftimi e datës 01.04.2019 me shifër 02-361, e lëshuar nga e paditura, Komuna e Prizrenit dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura”*.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e pala e paditur, përmes të autorizuarit të saj, për shkak shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, dhe të ndryshohet aktgjykimi A.nr.2330/2021, të datës;27.12.2023 i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ose aktgjykimi i ankimuar të prishet, çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala paditëse.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet

Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe ka gjetur se ankesa e palës së paditur është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me njoftimin e datës 01.04.2019 me shifër 02-361, është refuzuar ankesa e paditësit lidhur me fituesit të tenderit të lokalëve në pronë komunale. Me tej, me Njoftimin e Komisionit për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim dhe Këmbim të datës 22.03.2019, si dhe rezultatet e tenderit mbi dhënien e lokaleve me qira është njoftuar se ankesa është refuzuar dhe se lokalit pronë komunale do të shfrytëzohet nga fituesi i tenderit sipas njoftimit të datës;17.01.2019, të Komisionit Komunal për dhënien të Pronës komunale në shfrytëzim dhe këmbim.

I pakënaqur me njoftimin e të paditurës paditësi, ka ushtruar padi me datë;07.10.2021, kundër të paditurës, Komuna e Prizrenit, ndërsa me parashtrësën për rregullimin e padisë nga aspekti objektiv të datës;25.10.2023, ka kërkuar që të anulohet njoftimi e datës;01.04.2019 me shifër 02-361, e lëshuar nga e paditura, Komuna e Prizrenit.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër të paditurës, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, me arsyetim se *“Gjykata shqyrtoi aktin administrativ të goditur me padi në përputhje me nenin 35 Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se: “Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigjen”. Po ashtu edhe në bazë të nenit 44.2 të njëjtig ligj i cili përcakton se: “Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare”. Gjykata shqyrtoi kërkesëpadinë e paditësit dhe vlerësoi se në raport me këtë akt administrativ konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Paditësi i pakënaqur me këtë Njoftim, i është drejtuar kësaj Gjykate me padi, duke kontestuar ligjshmërinë e të njëjtës. Gjykata vëren se në këtë rast, gjatë vendosjes nga organi i paditur, lidhur me ankesën e paditësit të datës 21.01.2019, gjen se është cenuar ligji në dëm të paditësit, prandaj njoftimi me numër te referencës 02-361 e datës 01.04.2019, e lëshuar nga e paditura, nuk mund të merret si e drejtë dhe e bazuar në ligj, për arsye se për vendosjen lidhur me ankesën e paditësit, e paditura ka qenë i detyruar të merr aktvendim dhe atë duke iu referuar nenit 11 të Ligjit për Procedurën Administrative, i cili përcakton se “organet e Administratës Publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizik dhe juridik”. Nga kuptimi i drejtë i dispozitës së lartcekur, del se organi i paditur, ka qenë i detyruar që lidhur me ankesën e paditësit të datës 21.01.2019, të vendosë me aktvendim, i cili duke u bazuar në dispozitën e nenit 47.1.3, dhe nenin 48 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar, respektivisht, në nenin 48 parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit, ndërsa, nëse*

është i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës, apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Prandaj të metat e cekura më lartë, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kundërshtuar, ndërsa rrethanat e reja tek e paditura mundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës administrative, në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej 30 ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë, e të bazuar në ligj, me të cilin do të njoftohen palët me kohë”.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), lidhur me nenin 63 të LKA-së, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, këto pretendime janë të pabazuara për arsye se dispozitivi i aktgjykitimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykitimit, në aktgjykim janë dhënë arsyet për faktet vendimtare, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Po ashtu sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit të vendimit Gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se e paditura në ankesë, edhe kësaj shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, kur ka nxjerrë përfundim se “Gjykata vëren se në këtë rast, gjatë vendosjes nga organi i paditur, lidhur me ankesën e paditësit të datës 21.01.2019, gjen se është cenuar ligji në dëm të paditësit, prandaj njoftimi me numër te referencës 02-361 e datës 01.04.2019, e lëshuar nga e paditura, nuk mund të merret si e drejtë dhe e bazuar në ligj, për arsye se për vendosjen lidhur me ankesën e paditësit, e paditura ka qenë i detyruar të merr aktvendim dhe atë duke iu referuar nenit 11 të Ligjit për Procedurën Administrative, i cili përcakton se “organet e Administratës Publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizik dhe juridik”. Nga kuptimi i drejtë i dispozitës së lartcekur, del se organi i paditur, ka qenë i detyruar që lidhur me ankesën e paditësit të datës 21.01.2019, të vendosë me aktvendim, i cili duke u bazuar në dispozitën e nenit 47.1.3, dhe nenin 48 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar, respektivisht, në nenin 48 parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë

apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit, ndërsa, nëse është i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës, apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”.

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, pasi që e pala e paditur me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e saj ankimore, ndërsa provat e propozuara si prova të bashkangjitura me shkresat e lëndës nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Gjendja e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Mbi këto arsye kolegji i apelit këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuara, prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, dhe mbi këtë bazë ankesa e palës së paditur u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.100/2024, datë;31.10.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti